



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3668/10 prot.

Datë 02.02.2026

V E N D I M

Nr.174/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.02.2026 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Fred Electronic” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-64321-10-09-2025, me objekt: “Inkubatori i biznesit në arkitekturë dhe ndërtim në Tiranë- Pajisje elektronike”, me fond limit 25,561,492.97 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Prosound” SHPK & “Infosoft Systems” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “Fred Electronic” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit

Autoriteti Kontraktor:	Fondi Shqiptar i Zhvillimit Adresa: Rruga “Samë Frashëri”, nr. 10, Tiranë.
Ankimues:	Operatori ekonomik “Fredë Electronic” SHPK, me NIPT K91803020F, dhe Rruga e Kavajes, pallati 207, shk.2, Tiranë. Operatori ekonomik “PC Store” SHPK me NIPT L01606034A dhe adresë: Rruga e Dibres, Vila nr.153, Kati i Parë, Tiranë.
Subjekte të Interesuara:	Operatori ekonomik “Fredë Electronic” SHPK, me NIPT K91803020F, dhe Rruga e Kavajes, pallati 207, shk.2, Tiranë. Operatori ekonomik BOE “Prosound” SHPK & “Infosoft Systems” SHPK me NIPT K62320012O, J61820021C dhe adresë: Komuna e Parisit, Rruga Bilal Golemi, Nd.28, H.1., Tiranë.
Baza Ligjore:	Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 <i>“Për Prokurimin Publik”</i> , Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 <i>“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”</i> , i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 <i>“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”</i> , dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 <i>“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”</i> .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I.6. Ankimuesi “Fred Electronic” SHPK nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.10.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-64321-10-09-2025, me objekt: “Inkubatori i biznesit në arkitekturë dhe ndërtim në Tiranë- Pajisje elektronike”, me fond limit 25,561,492.97 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 25.11.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 11.12.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

BOE Prosaund &Infosoft Systems	23.991.650 lekë	Kualifikuar
Pc Store	24.823.000 lekë	Kualifikuar
Instant.Al	21.727.260 lekë	Skualifikuar
Fredi Electronic	16.721.400 lekë	Skualifikuar
Naol	Pa ofertë ekonomike	Skualifikuar

II.4. Në datën 18.12.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 22.12.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6199 dhe nr.3668/2025 prot, datë 23.12.2025 i operatorit ekonomik “Fred Electronic” SHPK, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Fred Electronic” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.3668/1 prot, datë 23.12.2025.

II.5.2. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, operatori ekonomik “Pc Store” SHPK, ka paraqitur formular argumentash, protokolluar me tonën me nr.3668/2, prot., datë 24.12.2025, për lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “Fred Electronic” SHPK.

II.5.3. Me shkresën nr.3668/3 prot., datë 13.01.2026, KPP iu drejtua autoritetit kontraktor duke i kërkuar informacion si më poshtë: “[...] Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “Fred Electronic” SHPK, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes”.

II.5.4. Autoriteti kontraktor, me shkresën nr.193/1prot., datë 13.01.2026, me objekt “Kthim përgjigje shkresës nr.3668/3 prot., datë 13.01.2026..” protokolluar me tonën me nr.3668/4 prot., datë 19.01.2026, ka informuar Komisionin e Prokurimit Publik si më poshtë vijon: “Në vijim të administrimit të ankesës së paraqitur, me objekt shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Fred Electronic” SHPK, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës pranë autoritetit kontraktor vëren se operatori ekonomik “Fred Electronic” SHPK, nuk e ka paraqitur ankesën duke i bashkëlidhur dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

Per sa me siper me shkresën nr. 5080 Prot., datë 31.12.2025, autoriteti kontraktor i ka kërkuar operatorit ekonomik plotësimin e ankesës me mandat-pagesën përkatëse, në përputhje me

nenin 94 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Referuar nenit 94 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, në mungesë të pagesës së tarifës përkatëse, ankesa konsiderohet sikur nuk është paraqitur dhe për rrjedhojë, KSHA vendosi për të mos vijuar me shqyrtimin në themel të pretendimeve të parashtruara, Zgjatja e afateve procedurale ka ardhur si pasojë e përkimit të shqyrtimit të çështjes me periudhën e festave zyrtare të fundvitit, (dhjetor-Janar) gjatë së cilës aktiviteti administrativ ka qenë i kufizuar dhe anëtarët e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave nuk kanë qenë plotësisht të disponueshëm, çka ka ndikuar në pamundësinë objektive për zhvillimin e procesit të vendimmarrjes.

Par sa më sipër bashkëlidhur ju lutem gjeni shkresën me nr. 5080 Prot., datë 31.12.2025 për plotësimin e dokumentacionit dhe shkresën nr. 150/1 Prot, datë 12.01.2026 dhe vendimin e KSHA drejtuar operatorit ekonomik "Fred Electronic" SHPK si dhe Komisionit të prokurimit Publik."

II.5.6. Referuar vendimit të KSHA datë 09.01.2026, rezulton se ky i fundit ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes "Fred Electronic" SHPK dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj duke argumentuar: [...] Në zbatim të nenit 111 të Ligjit nr. Nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën prokurimin publik, i ndryshuar, operatore Komisionin e Prokurimit Publik.

Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe prova perkatese, per te cilat mendon se mbështesin ankimin e tij.

Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

Sa më sipër vërehet se operatori ekonomik "Fred Electronic" SHPK, nuk e ka paraqitur ankesën duke i bashkëlidhur dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

Me shkresën nr. 5080 Prot., datë 31.12.2025, autoriteti kontraktor i ka kërkuar operatorit ekonomik plotësimin e ankesës me mandat-pagesën përkatëse, në përputhje me nenin 94 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Pavarësisht kësaj kërkesë, operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument bankar që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës së ankesës.

Referuar nenit 94 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, në mungesë të pagesës së tarifës përkatëse, ankesa konsiderohet sikur nuk është paraqitur dhe për rrjedhojë, KSHA vendosi per te mos vijuar me shqyrtimin në themel të pretendimeve të parashtruara,

II.5.7.Vendimin e KSHA datë 09.01.2026, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik "Fred Electronic" SHPK, autoriteti kontraktor e ka përcjellë pranë KPP edhe përmes shërbimit postar, protokolluar me tonën me nr. 3668/5 prot., datë 19.01.2026.

II.5.8. Me qëllim vijim e shqyrtimit të mëtejshëm të ankesës nga KPP me shkresën nr.3668/6 prot., datë 20.01.2026 ju kërkua informacion Sektorit të Financës mbi statusin aktual të pagesës për ankesën objekt shqyrtimi.

II.5.9.Me shkresën nr 3668/7 prot., datë 21.01.2026, lidhur me kërkesën e bërë për statusin e ankesës së operatorit ekonomik “ Fredi Electronic” SHPK, Sekori i Financës informon se: “ [...] Për ankesën me nr.3668/2025 prot., datë 23.12.2025, me numër aplikimi elektronik A/2025/6199, Operatori ekonomik “ Fredi Electronic” SHPK, nuk ka paraqitur dokument në seksion mandat pagese. Në vijim të shkresës tuaj janë kryer verifikime me raportin e datës 22.01.2026 të dërguar nga Dega e Thesarit për arkëtimet e periudhës 01.12.2025-16.01.2026, rezulton se Operatori ekonomik “Fredie Electronic” SHPK nuk ka kryer pagesë për ankesën e sipërcituar në favor të Komisionit të Prokurimit Publik”.

II.6. Në datën 23.12.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6206 dhe nr.3689/2025 prot, datë 24.12.2025 i operatorit ekonomik “PC Store” SHPK, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave, për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Prosound” SHPK & “Infosoft Systems” SHPK dhe lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “Fredie Electronic” SHPK, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit..

II.6.1.Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.3689/1 prot, datë 24.12.2025.

II.6.2. Me shkresën nr.3689/2 prot., datë 13.01.2026, KPP iu drejtua autoritetit kontraktor duke i kërkuar informacion si më poshtë: “[...] Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “Pc Store” SHPK, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues”.

II.6.3. Autoriteti kontraktor, nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr.150 prot., datë 12.01.2026, protokolluar me tonën me nr.3689/3 prot., datë 15.01.2026, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin e KSHA datë 09.01.2026, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Pc Store” SHPK.

II.6.4. Referuar vendimit të KSHA datë 09.01.2026, rezulton se ky i fundit ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Pc Store” SHPK dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

II.6.5. Në datën 16.01.2026, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, operatori ekonomik ankimues pasi është njohur me vendimin e KSHA, ka praqitur argumenta shtesë ndaj vendimit të komisionit të sqyrtimit të ankesave, lidhur me mospranimin e ankimit, argumenta të cilat janë protokolluar me tonën me nr.3689/4 prot., datë 19.01.2026.

II.6.6. Vendimin e KSHA datë 09.01.2026, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Pc Store” SHPK, autoriteti kontraktor e ka përcjellë pranë KPP edhe me shkresën nr. 202/1 prot., datë 16.01.206, me objekt “*Kthim përgjigje shkresës nr.3689/2 prot., datë 13.01.2026...*”, protokolluar me tonën me nr.3689/5 prot., datë 19.01.2026.

II.6.7. Me shkresën nr.3689/6 prot., datë 19.01.2026, KPP iu drejtua autoritetit kontraktor duke i kërkuar informacion si më poshtë: “[...] Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar në KPP informacion për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, por autoriteti kontraktor duhet të dërgojë të plotë ***kopje të njësuar me origjinalin*** të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Prosound” SHPK & “Infosoft Systems” SHPK pranë autoritetit kontraktor si operator ekonomik i kualifikuar i pari sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

II.6.8. Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr.268/1prot., datë 23.01.2026, me objekt “*Dërgim dokumentacioni*”, protokolluar me tonën me nr. 3689/7 prot., datë 26.01.2026, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë KPP informacionin e kërkuar.

II.6.9. Në datën 26.01.2026, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, operatori ekonomik ankimues pasi është njohur me shkresën e autoritetit kontraktor nr.268/1 prot., datë 23.01.2026, me objekt “*Dërgim dokumentacioni*”, ka praqitur argumenta shtesë ndaj vendimit të komisionit të sqyrtimit të ankesave, lidhur me mospranimin e ankimit, argumenta të cilat janë protokolluar me tonën me nr.3689/8 prot., datë 26.01.2026.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me ankesën e administruar në datën 22.12.2025 me nr. A/2025/6199 dhe nr.3668/2025 prot, datë 23.12.2025, e operatorit ekonomik “Fred Electronic” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-64321-10-09-2025, me objekt: “Inkubatori i biznesit në arkitekturë dhe ndërtim në Tiranë- Pajisje elektronike”, me fond limit 25,561,492.97 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, mbi kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur prej tij, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare për ankesën e mësipërme, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.1.1. Në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është parashikuar se: *“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.*

III.1.2. Autoriteti kontraktor me shkresën nr.193/1prot., datë 13.01.2026, me objekt *“Kthim përgjigje shkresës nr.3668/3 prot., datë 13.01.2026”*, protokolluar me tonën me nr.3668/4 prot., datë 19.01.2026 ka përcjellë vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave datë 09.01.2026, lidhur me ankesën e operatorit ankimues “Fred Electronic” SHPK. Referuar vendimit të KSHA rezulton se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës së ankimuesit si të paparaqitur, për shkak të moskorrigjimit të të metave të ankesës nga operatori ekonomik ankimues.

III.1.3. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar,

Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t'i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në KPP, vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave datë 09.01.2026, protokolluar me tonën me nr.3668/4 prot., datë 19.01.2026, lidhur me ankesën e operatorit ankimes “Fred Electronic” SHPK, rezulton, se autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, duke respektuar hapat proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore, sepse përmes shkresës nr. 5080 Prot., datë 31.12.2025, autoriteti kontraktor i ka kërkuar operatorit ekonomik “Fred Electronic” SHPK, ndreqjen e të metave të ankesës, në rastin konkret kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e paraqitur.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni Prokurimit Publik, konstaton se autoriteti kontraktor ka njoftuar (më datë 31.12.2025) operatorin ekonomik ankimes “Fred Electronic” SHPK përmes shkresës nr. 5080 Prot., datë 31.12.2025, në lidhje me korrigjimin e mangësive të konstatuara në lidhje me elementet formale të ankesës, konkretisht pagesës së tarifës së ankesës. Gjithashtu me shkresën nr.3668/6 prot., datë 20.01.2026, lidhur me kërkesën e bërë për statusin e ankesës së operatorit ekonomik “Fred Electronic” SHPK, Sekori i Financës informon se: “ [...]Për ankesën me nr.3668/2025 prot., datë 23.12.2025, me numër aplikimi elektronik A/2025/6199, Operatori ekonomik “Fred Electronic” SHPK, nuk ka paraqitur dokument në seksion mandat pagese. Në vijim të shkresës tuaj janë kryer verifikime me raportin e datës 22.01.2026 të dërguar nga Dega e Thesarit për arkëtimet e periudhës 01.12.2025-16.01.2026, rezulton se Operatori ekonomik “Fred Electronic” SHPK nuk ka kryer pagesë për ankesën e sipërcituar në favor të Komisionit të Prokurimit Publik..

Sa më sipër, konstatohet se ankimesi nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës në përputhje me përcaktimet e pikës 2 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar duke mos plotësuar kështu një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës.

Sa më sipër argumentuar, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se, për sa kohë ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues nuk plotëson kushtet formale, siç është pagesa e tarifës, duhet refuzuar.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, “PC Store” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik BOE “Prosound” SHPK & “Infosoftware Systems” SHPK, me arsyen se: *“BOE PROSOUND& INFOSOFTWARE SYSTEMS nuk plotëson kriteret në lidhje me dorëzimin e vërtetimeve të pagimit të detyrimeve tatimore dhe kontributeve”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 8 “Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 1. *“Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”*, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

Këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

III.2.2. Në shtojcën 9 *“Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”*, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën II, *“Shkaqet e përjashtimit”*, Pika A *“Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”*, parashikohet

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITERËVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

III.2.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të kriterëve të përgjithshme për kualifikimi dhe kriterëve të vecanta (të cilat përmbushen fillimisht përmes deklarimeve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit) në fazën e ofertimit operatori ekonomik BOE Prosound & Infosoftware Systems SHPK ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- *Marrëveshje bashkëpunimi datë 25.11.2025, mes operatorëve ekonomikë Prosound SHPK & Infosoftware Systems SHPK;*
- *Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Prosound” SHPK të nënshkruar dhe vulosur nga vetë ai me datë të dorëzimit të deklaratës 25.11.2025*

- *Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Infosoft Systems” SHPK të nënshkruar dhe vulosur nga vetë ai me datë të dorëzimit të deklaratës 25.11.2025*

III.2.4. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: 1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) falsifikim;

e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shumën të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

- a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;
- b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;
- c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;
- d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;
- e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.
- ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;
- f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.
- g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- gj) operatori ekonomik nuk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- h) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pagtuar në punë. Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën
4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti

kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një vepr penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

8. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim.

III.2.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore

minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.6. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.2.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 2 dhe 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të

ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij . Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

III.2.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, nëpërmjet kriterëve për kualifikim, synohet sigurimi i ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e tenderit janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.2.9. Nisur nga pretendimet më sipër të ankimesit, për skualifikimin e operatorit ekonomik BOE “Prosound” SHPK & “Infosoft Systems” SHPK, me arsyen se: *“nuk plotëson kriteret në lidhje me dorëzimin e vërtetimeve të pagimit të detyrimeve tatimore dhe kontributeve”*, SHPK, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik BOE “Prosound” SHPK & “Infosoft Systems” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur për secilin anëtarë të bashkimit të operatorëve ekonomikë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të firmosur dhe vulosur, me datë të deklaratës 25.11.2025, ku për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit dhe kriterëve të vecanta të kualifikimit të cilat si fillim përmbushen përmes deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ka kryer deklarimet në këtë formular. Duke qenë se operatori ekonomik BOE “Prosound” SHPK & “Infosoft Systems” SHPK, sipas vendimit të KVO-së është operatori ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor ndër të tjera dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të nenit 26 të aktit rregullator të mësipërm dokumente të cilat autoriteti kontraktor i ka vënë në dispozicion të KPP-së me shkresën nr.268/1, datë 23.01.2026, me lëndë *“Dërgim dokumentacioni”*, protokolluar me tonën me nr. 3689/7 datë 26.01.2026, bashkë me dokumente të tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, në brendësi të të

cilit ndër të tjera gjendet dokumentacioni për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme për kualifikim të cilat si fillim përmbushen përmes deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si më poshtë:

- *Vërtetim për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për subjektin Infosoft Systems SHPK nr. T14517064, datë 14.11.2025 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë;*
- *Vërtetim për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për subjektin Prosaund SHPK nr. T14698407, datë 15.12.2025 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë;*

Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimesit, dhe duke i ballafaquar me kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe kriteret e vecanta, të cilat si fillim përmbushen përmes deklarimeve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik BOE “Prosaund” SHPK & “Infosoft Systems” SHPK, si dhe dokumentacionin fizik të paraqitur nga ky i fundit në autoritet kontraktor për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, KPP gjykon, se operatori ekonomik BOE “Prosaund” SHPK & “Infosoft Systems” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar në autoritet kontraktor bazuar në deklaratimet e bëra për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, i cili shërben si provë për vërtetimin e këtyre deklarimeve, nuk i përmbush kërkesat e autoritetit kontraktor. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme për kualifikim, operatori ekonomik BOE “Prosaund” SHPK & “Infosoft Systems” SHPK ndër të tjera ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjën “dh” të pikës 2, të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të cilat i ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe që janë detyrim ligjor për tu paraqitur në autoritet kontraktor nga ana e operatorit ekonomik të kualifikuar i pari. Nga ana tjetër, autoriteti kontraktor këto dokumenta i ka vënë në dispozicion të KPP-së me shkresën nr.268/1 prot, datë 23.01.2026 me lëndë “Dërgim dokumentacioni”, protokolluar me tonën me nr. 3689/7 prot., datë 26.02.2026, bashkë me dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Nga shqyrtimi i kriterëve kualifikues të përcaktuar vihet re se autoriteti kontraktor në këtë fazë plotësimin e kriterëve të përgjithshme për kualifikim e ka lidhur me deklaratimet që duhet të kryhen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit konkretisht në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, Pika A “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit” të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Bazuar në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 6, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik, i cili pas fazës së vlerësimit kualifikohet i pari, duhet që përpara publikimit të njoftimit të fituesit e nisjes së afateve të ankimit, të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të nenit 26 të aktit rregullator të sipërcituar, të cilat janë deklaruar në shtojcën 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, dhe çfarë është e rëndësishme këto dokumenta duhet të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se më datë 25.11.2025

autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, që do të thotë ka hapur për vlerësim ofertat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Referuar parashikimeve më sipër të aktit rregullator dokumentet provues të deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit duhet të provojnë gjendjen faktike të subjektit në momentin e ofertimit, pra me datë 25.11.2025, datë në të cilën janë hapur për vlerësim ofertat. Nga verifikimet e dokumenteve provuese të cilët janë deklaruar në shtojcën 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe të dorëzuara në autoritet kontraktor nga operatori ekonomik BOE “Prosound” SHPK & “Infosoft Systems” SHPK, si i kualifikuar i pari rezulton se, dokumentacioni provues i parashikuar në shkronjën “dh” të pikës 2, të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar, nuk është i vlefshëm për përmbushjen e deklarimeve të bërë në datën 25.11.2025, pasi në këtë datë dokumenti (*Vërtetim për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shendetesore për subjektin Prosaund SHPK nr. T14698407, datë 15.12.2025 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë*) mbi vërtetimin e pagesës së detyrimeve për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së të subjektit “Prosound” SHPK, si pjesë e BOE “Prosound” SHPK & “Infosoft Systems” SHPK nuk ishte lëshuar akoma nga organet kompetente dhe deklaratimet e datës 25.11.2025 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit nuk mund të provohen me dokumentacion që nuk ka ekzistuar në këtë datë, pra në datën e hapjes së ofertave. KPP gjykon, se operatori ekonomik “Prosound” SHPK, si pjesë e BOE “Prosound” SHPK & “Infosoft Systems” SHPK, duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor në sistemin elektronik të prokurimeve me datë lëshimi para hapjes së ofertave dhe si rrjedhim duhet të dorëzonte dokumentacionin e cituar më sipër në këtë vendim me datë lëshimi të dokumentave jo më vonë se me datë 25.11.2025. Nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Nuk mund të lejohet paraqitja e asnjë dokumenti tjetër pas mbarimit të afatit për hapjen e ofertave, pasi një gjë e tillë do të konsiderohej ndërhyrje në ofertë. Vlerësimi i dokumentacionit, i cili do të sigurohej në të ardhmen nga operatorët ekonomikë, do të cenonte në thelb konceptin e prokurimit publik, i cili i nënshtrohet afateve të përcaktuara procedurale ligjore. KPP nuk mund të vlerësojë një fakt apo dokument të ri, i cili sigurohet pas datës së hapjes së ofertave, në respektim të parimit të barazisë, mosdiskriminimit, referuar nenit 3, pika 1 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar ku parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Përsa më sipër, Komisioni gjykon se dokumentacioni provues i parashikuar në shkronjën “dh”, të pikës 2, të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar, i datës 15.12.2025 i paraqitur nga operatori ekonomik “Prosound” SHPK, si pjesë e BOE “Prosound” SHPK & “Infosoft Systems” SHPK, si provë e deklarimit të bërë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme për kualifikim duke qenë se ka datë të mëvonshme nga data e hapjes së ofertave (me 25.11.2025) nuk provon gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij në

kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore e rregullatore në fuqi për prokurimin publik dhe si rrjedhim nuk do të konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Pc Store” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik BOE “Prosound” SHPK & “Infosoft Systems” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë gjendja faktike e juridike e operatorit ekonomik BOE “Prosound” SHPK & “Infosoft Systems” SHPK referuar arsyetimit të bërë në pikën III.2.9 të këtij vendimi do të ndryshojë nga e kualifikuar në të skualifikuar, duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Pc Store” SHPK për lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “Fred Electronic” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë gjendja faktike e juridike e operatorit ekonomik “Fred Electronic” SHPK referuar arsyetimit të bërë në pikën III.1.3 të këtij vendimi do të vijojë të mbetet e skualifikuar, duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit, shqyrtimi në themel i pretendimeve të palës ankimuese nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Fred Electronic” SHPK në procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-64321-10-09-2025, me objekt: “Inkubatori i biznesit në arkitekturë dhe ndërtim në Tiranë- Pajisje elektronike”, me fond limit 25,561,492.97 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “PC Store” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit

3. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik BOE “Prosound” SHPK & “Infrosoft Systems” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.
 4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “PC Store” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

